

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për asociacione dhe fondacione (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, Nr. 52/2010 dhe 135/2011), Kuvendi themelues i Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë, në seancën e mbajtur në vitin 2017, nxori

STATUTIN

e Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë statut rregullohen: emërtimi dhe selia, objektivat e shoqatës; veprimtaritë me të cilat realizohen objektivat; mënyra e vendosjes për anëtarësimin, për përjashtimin dhe për pushimin e anëtarësimit në shoqatë; të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve; lloji i organeve dhe përbërja e tyre; mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit; kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve në organe dhe mënyra e vendosjes; përfaqësimi sipas ligjit; mënyra e krijimit dhe e posedimit të mjeteve; mënyra e miratimit të raporteve financiare dhe të raporteve të tjera; mënyra e realizimit të transparencës dhe e përgjegjësisë në punë; mënyra e nxjerrjes, e ndryshimit dhe e plotësimit të statutit; mënyra e vendosjes për ndryshimet statusore dhe për pushimin e shoqatës; mënyra e nxjerrjes së plan-programeve, administrimi i mjeteve dhe/ose i pasurisë në rast pushimi të shoqatës si dhe çështje të tjera të përcaktuara me ligj; format organizative të brendshme; mënyra e nxjerrjes së akteve të tjera; konflikti i interesave; mënyra e zgjidhjes së çështjeve të kontestueshme dhe çështje të tjera, me rëndësi për punën e shoqatës.

Neni 2

Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë është organizatë qytetare që ka për qëllim ta ngrejë vetëdijen arsimore dhe kulturore në mbarë popullatën, lidhur me përparimin në lëmin e shkencës dhe të artit. Qëllimi i shoqatës është angazhimi në veprimtari të ndryshme që kontribuojnë në përparimin e përvojës arsimore dhe në ngritjen kulturore. Shoqata angazhohet për gjetjen dhe për grumbullimin e fondeve për ta përmirësuar ngritjen arsimore, sidomos të studentëve të talentuar që janë me perspektivë, por që nuk kanë mundësi për t’i realizuar qëllimet e veta akademike dhe shkencore. Shoqata do t’u ndihmojë të tjerëve për t’u bërë qytetarë më të devotshëm nëpërmjet ngritjes arsimore dhe kulturore.

Neni 3

Themeluesit e Asociacionit për edukim PENA AEP Tetovë, të drejtat dhe përgjegjësitë e veta i përmbushin me aktin e themelimit të shoqatës.

Me statut dhe me akte të përgjithshme dhe të veçanta, nuk mund të përcaktohen të drejta dhe përgjegjësi të posaçme të themeluesve të shoqatës.

Neni 4

Shoqata është themeluar për kohë të pacaktuar.

II. EMËRTIMI DHE SELIA

Neni 5

Emërtimi i shoqatës në gjuhën maqedonas është: *Асоцијација за Едукација ПЕНДА АЕП Тетово*.

Emërtimi i shkurtër i shoqatës në gjuhën maqedonase është: *ПЕНДА АЕП Тетово*.

Emërtimi i shoqatës në gjuhën shqipe është: *Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë*.

Emërtimi i shkurtër i shoqatës në gjuhën shqipe është: *PENDA AEP Tetovë*.

Motoja e shoqatës në gjuhën maqedonase është: *Еманципација, Знаење, Мудрост*.

Motoja e shoqatës në gjuhën shqipe është: **Emancipim, Dituri, Urtësi**.

Neni 6

Selia e shoqatës ndodhet në Tetovë, Rr. “Ivo Lolla Ribar”, Nr. 8. Vendimin e vendndodhjes së selisë e merr Kuvendi.

Neni 7

Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë e ka vulën e vet si dhe vulën katrore.

Vula e shoqatës është në formë të rrumbullakët dhe në të është shkruar teksti në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik: *Асоцијација за Едукација ПЕНДА АЕП Тетово*.

Vula katrore e shoqatës është në formë të drejtkëndëshit dhe në të është shkruar teksti: *Асоцијација за Едукација ПЕНДА АЕП Тетово*. Në të figuron vendi i numrit të protokollit, data dhe shtojca.

Përdorimin e vulës dhe të vulës katrore të Asociacionit për Edukim PENDA AEP Tetovë e përcakton Këshilli ekzekutiv.

III. OBJEKTIVAT

Neni 8

Objektivi themelor i shoqatës është përfaqësimi dhe lobimi për përparimin e legjislativit, ngritja e vetëdijes publike dhe afirmimi i të drejtave të studentëve të talentuar që janë me perspektivë, si dhe sendërtimi i qëllimeve të tyre personale, profesionale dhe shkencore akademike.

Neni 9

Objektiva afatgjatë të Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë janë:

- të sigurojë bursa për studentët e suksesshëm dhe të talentuar të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta vazhduar ngritjen arsimore të tyre;
- të ofrojë këshilla dhe mentorim për studentët e suksesshëm dhe të talentuar të cilët kanë nevojë për bursa për ngritjen profesionale të tyre;
- të ndjekë përparimin e studentëve të cilët marrin bursa prej shoqatës sonë dhe të vlerësojë nëse është e arsyeshme të vazhdojë të japë bursa për të njëjtit;
- të organizojë ngjarje të ndryshme sociale me qëllim të rritjes së interesit publik në lëmin shkencor, artistik dhe kulturor;
- të kërkojë donacione nga organizatat/institucionet e vendit dhe të huaja për të siguruar mjete pune; si dhe
- të grumbullojë buxhetin operativ minimal nga anëtarët e vet.

Objektiva të tjerë të Shoqatës janë:

- rritja e numrit të anëtarëve, duke tërhequr persona me ide të ngjashme të cilët janë të interesuar për përparimin e objektivave të kësaj shoqate;
- paraqitjet në medime për ngritjen e nivelit të afirmimit të shoqatës;
- ndihmë studentëve për përparimin e karrierave akademike të tyre, duke mbështetur vizita në kampet verore, në konferenca, nëpër institucionet akademike në vendin tonë por edhe jashtë vendit;
- krijimi i mjedisit motivues intelektual në të cilin studentët do të mund t'i këmbëjnë përvojat e veta dhe t'i ndihmojnë njëri-tjetrit për arritjen e synimeve të tyre arsimore;
- të bashkëpunojë, të lidhet dhe të anëtarësohet në organizata të tjera të vendit dhe në ato ndërkombëtare, të cilat punojnë në çështje të njëjta apo të ngjashme;
- të sigurojë kushte materiale, financiare dhe juridike për punën e shoqatës dhe të anëtarëve të saj;

Neni 10

Shoqata është në shërbim të qytetarëve (të njerëzve), pa dallim përkatësie kombëtare, religjioze apo përkatësie dhe përcaktimi tjetër.

Shoqata do t'u drejtohet sidomos faktorëve dhe vendim-marrësve, për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin e bursave për studentët me të hyra të kufizuara.

Neni 11

Parimet mbi të cilat mbështetet puna e Shoqatës janë: *pavarësia, karakteri publik i punës dhe transparenca, jofitimprurja, veprimi jopartiak, nismat në jetën publike,*

participimi (pjesëmarrja), partneriteti, toleranca, ndërmarrësia, qëndrueshmëria dhe mundësitë e barabarta.

Neni 12

Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë vepron në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Shoqata vepron edhe në nivel ndërkombëtar, në përputhje me politikën dhe me strategjinë e vet të përgjithshme.

IV. ANËTARËSIMI

Neni 13

Anëtar i Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë mund të jetë çdo qytetar, pavarësisht nga mosha e tij, i cili aderon në mënyrë vullnetare dhe i pranon objektivat e shoqatës, të përcaktuar me këtë statut. Anëtarësimi inicohet me nominimin e kandidatit, të paktën prej dy anëtarëve aktualë të Këshillit ekzekutiv. Pas emërimit, pranimin e anëtarit të ri e miraton Këshilli ekzekutiv. Personi i mitur që ka mbushur 14 vjeç, anëtarësohet në shoqatë në bazë të deklaratës me shkrim, të nënshkruar nga përfaqësuesi i tij ligjor.

Anëtarësimi bëhet duke plotësuar dhe duke nënshkruar fletanëtarësimin.

Çdo anëtar i jepet librezë anëtarësimi.

Formën dhe përmbajtjen e fletanëtarësimin dhe të librezës së anëtarësimin e cakton Këshilli ekzekutiv.

Neni 14

Shoqata mban regjistër anëtarësh.

Të dhënat në regjistër azhurnohen të paktën një herë në dy vjet dhe mbrohen në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të informatave të klasifikuara.

Asociacioni PENDA e garanton anonimitetin e të dhënave personale në regjistrin e anëtarëve të cilët kërkojnë një gjë të tillë.

Neni 15

Çdo anëtar i shoqatës ka të drejta dhe përgjegjësi, në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe të akteve të tjera të shoqatës.

Çdo anëtar ka të drejtë të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet dhe në forumet e shoqatës, si dhe të përfshihet në të gjitha veprimtaritë e shoqatës.

Çdo anëtar i shoqatës paguan anëtarësi vjetore.

Vendimin për masën dhe për mënyrën e pagesës së anëtarësisë e merr Këshilli ekzekutiv.

Neni 16

Anëtarësia në Shoqatë pushon duke dalë vullnetarisht prej saj, ose duke u përjashtuar prej saj.

Çdo anëtar mund të dalë nga shoqata vullnetarisht duke nënshkruar deklaratë me shkrim dhe duke e kthyer librezën e anëtarësisë.

Anëtarësia pushon nëpërmjet përjashtimit, në rastet kur anëtari:

- nuk e respekton statutin dhe aktet e tjera të shoqatës;
- vepron në kundërshti me objektivat e shoqatës;
- nuk e paguan anëtarësinë vjetore dy herë radhazi;

Anëtarësia mund të merret vetëm nga Këshilli ekzekutiv.

Me rastin e pushimit të anëtarësisë në shoqatë, fletanëtarësimi kthehet me shënimin se anëtari është larguar vetë, përkatësisht është përjashtuar nga shoqata.

Neni 17

Personi i cili e humb anëtarësinë në shoqatë, njëherazi i humb edhe të gjitha pozicionet e tjera që ekzistojnë në kuadër të shoqatës. Këto pozicione hapen për plotësim në bazë të procedurave të rregullta.

V. ORGANET E SHOQATËS

Neni 18

Organe të Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë janë: Kuvendi, Këshilli ekzekutiv, kryetari dhe nënkryetari.

Kryetari është përfaqësues i shoqatës.

Organet e shoqatës zgjidhen sipas mënyrës së përcaktuar me këtë statut. Kandidatët për anëtarë të organeve të shoqatës duhet të jenë persona me integritet, me kompetencë dhe të afirmuar.

Anëtarët e organeve të shoqatës veprojnë me kapacitetin personal dhe vendosin sipas bindjeve të veta.

1. Kuvendi

Neni 19

Kuvendi i Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë është organi më i lartë i shoqatës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës.

Kuvendi:

- nxjerr statutin, programin dhe aktet e tjera të shoqatës;
- miraton raportin vjetor të punës dhe raportin financiar dhe e shpall atë në ueb faqen e shoqatës;
- ia dërgon raportin financiar organit kompetent të administratës shtetërore, organit të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, në rastet kur shfrytëzohen mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht nga buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes vendore;
- vendos për ndryshimin e objektivit të shoqatës;
- vendos për organizimin e brendshëm dhe për format organizative të organeve të shoqatës;
- zgjedh dhe shkarkon kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e Këshillit ekzekutiv;
- vendos për ndryshimet e statutit të shoqatës;
- vendos për anëtarësimin dhe për daljen nga asociacionet dhe nga organizatat ndërkombëtare;
- vendos për pushimin e shoqatës me shumicën e dy të tretës së votave të të gjithë anëtarëve të shoqatës; dhe
- ushtron edhe punë të tjera, në përputhje me statutin dhe me aktet e shoqatës.

Neni 20

Kuvendi punon në seanca.

Kuvendi mban seancë (mbledhje) të paktën një herë në vit, por edhe sipas nevojës.

Seancat e Kuvendit i thirr kryetari, me nismën e vet, me kërkesën e Këshillit ekzekutiv apo me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të Kuvendit. Po qe se kryetari brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së propozimit nuk thirr seancë, atëherë seancën e thirr Këshilli ekzekutiv apo nismëtarët.

Kuvendi nxjerr rregullore pune me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 21

Seancën e Kuvendit e udhëheq kryesuesi.

Kryesuesi i Kuvendit zgjidhet në fillim të seancës për çdo seancë të veçantë, e pikërisht me propozimin e kryetarit, të Këshillit ekzekutiv apo të pesë anëtarëve të Kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit mund të zgjidhet çdo anëtar i Kuvendit, me përjashtim të kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit ekzekutiv.

Neni 22

Kuvendi ka të drejtë të vendosë po qe se në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Kuvendi vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, pra të paktën me një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, po qe se me këtë statut nuk parashikohet shumicë e veçantë.

Kuvendi, për të gjitha çështjet vendos me votim të hapur.

Kuvendi vendos me votim të fshehtë vetëm për zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit, të nënkryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit ekzekutiv.

Anëtarët mund të marrin pjesë në votim dhe nëpërmjet telekonferencës.

Neni 23

Për punën e Kuvendit mbahet procesverbal që i përmban të dhënat të përcaktuara me rregulloren e punës.

Procesverbalin e mban mbajtësi i procesverbalit dhe verifikohet nga kryesuesi i Kuvendit si dhe nga kryetari.

2. Përfaqësues

Neni 24

Përfaqësues i shoqatës është kryetari.

Kryetari dhe nënkryetari janë persona, të drejtat, autorizimet dhe përgjegjësitë e të cilëve ndërlidhen me udhëheqjen e shoqatës si dhe me përfaqësimin e shoqatës, në përputhje me ligjin dhe me këtë statut.

Mandati i kryetarit dhe i nënkryetarit zgjat 4 vjet dhe është i kufizuar jo më shumë se në dy mandate.

Neni 25

Kryetari:

- e përfaqëson shoqatën në qarkullimin juridik me persona të tretë dhe është përgjegjës për komunikim dhe për bashkëpunim me persona të tjerë;

- përcjell dhe analizon gjendjen, problemet dhe politikat publike në veprimtarinë e shoqatës, jep prognoza dhe parashikime, ndërmerr nisma dhe jep propozime për përparimin e punës;

- kujdeset (identifikon, zhvillon dhe zbaton) për planifikimin strategjik dhe i përgatit programet perspektive, vjetore dhe periodike si dhe planet afariste (me planet financiare) dhe është përgjegjës për realizimin e tyre;

- i paraqet raporte periodike Këshillit ekzekutiv si dhe raporte vjetore – Kuvendit;

- e udhëheq organizatën dhe e zhvillon kulturën organizative;

- vendos procedura përkatëse për punën e shoqatës;

- formon komisione dhe grupe pune regjistrimi si dhe komisione dhe grupe pune të tjera;

- kujdeset për administrimin e drejtë dhe ekonomik të mjeteve të shoqatës si dhe e administron rrjedhën e parave;
- vendos për krijimin e marrëdhënies së punës dhe i udhëheq dhe i motivon bashkëpunëtorët;
- i përcakton treguesit dhe i vlerëson arritjet në punë, dhe
- ushtron punë të tjera, të përcaktuara me ligj dhe me statut.

Kryetari është përgjegjës:

- për ligjshmërinë, rregullsinë dhe kryerjen në kohë të punëve të shoqatës si dhe për sigurimin e kushteve të punës, në përputhje me ligjet, me statutin dhe me aktet e përgjithshme të shoqatës;
- për përgatitjen dhe për prezantimin në kohë, objektiv dhe të saktë të raporteve financiare;
- për administrimin dhe për përcjelljen e rreziqeve, të cilave u ekspozohet shoqata.

Kryetari, në kuadër të të drejtave dhe të autorizimeve të veta, mund t'i japë ndonjë personi tjetër autorizim me shkrim, për të ndërmarre veprime të caktuara juridike, si dhe për ta përfaqësuar para organeve të jurisprudencës dhe organeve të tjera. Përmbajtjen, llojin, vëllimin dhe kohëzgjatjen e autorizimit e përcakton kryetari.

Neni 26

Kryetari e ka të drejtën e urdhrimit ekzekutiv. Urdhrat ekzekutivë duhet të shfrytëzohen rrallë dhe në raste të veçanta.

Urdhri ekzekutiv hyn në fuqi po qe se nuk mbivotohet nga Këshilli ekzekutiv apo nga gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

Urdhri ekzekutiv duhet të jetë publik për të gjithë anëtarët e shoqatës.

Po qe se ndaj urdhrimit ekzekutiv nuk vihet veto brenda një periudhe prej një muaji, me këtë rast ai hyn në fuqi.

Kryetari mund ta ndryshojë statutin e shoqatës nëpërmjet urdhrimit ekzekutiv.

Neni 27

Kryetari dhe nënkryetari zgjidhen nga anëtarët e Këshillit ekzekutiv.

Votimi bazohet në mekanizmin e *votës së vetme të transferueshme* (Single Transferable Vote - STV). Anëtarët mund të emërojnë çfarëdo numri të anëtarëve, duke përfshirë edhe vetë ata. Me rastin e votimit, anëtarët do t'i rangojnë preferencat e tyre.

Kryetari dhe nënkryetari do t'u ofrohen anëtarëve të Këshillit ekzekutiv sipas rangimit STV. Me rastin e votimit të kryetarit dhe të nënkryetarit në kuadër të sistemit të njëjtë STV, kryetari, në krahasim me nënkryetarin, duhet të jetë në rang më të lartë.

Neni 28

Në mungesë të kryetarit, rolin e tij e merr nënkryetari.

Neni 29

Kryetari ose nënkryetari mund të përjashtohen prej pozitave të tyre me dy të tretat e votave të Këshillit ekzekutiv.

3. Këshilli ekzekutiv

Neni 30

Këshilli ekzekutiv është organ i shoqatës, punët e të cilit janë të ndërlidhura me administrimin e përgjithshëm dhe me përcjelljen e veprimtarisë së përditshme të shoqatës.

Këshilli ekzekutiv përbëhet prej pesë anëtarëve.

Kuvendi mund të vendosë që kryetari i Shoqatës të jetë anëtar i Këshillit ekzekutiv si dhe kryesues i tij.

Mandati i anëtarëve të Këshillit ekzekutiv zgjat katër vjet, me të drejtën e rizgjedhjes.

Anëtarët e Këshillit ekzekutiv mund të kenë mandate të pakufizuara.

Neni 31

Këshilli ekzekutiv:

- nxjerr aktet e përgjithshme të shoqatës, me përjashtim të akteve që i miraton Kuvendi si dhe e përcjell zbatimin e statutit;
- merr vendime për shpërblimet, për lëvdatat dhe për mirënjohjet;
- merr vendime për blerjen dhe për tjetërsimin e mjeteve themelore;
- i propozon ndryshimet dhe plotësimet e statutit;
- e propozon programin vjetor të veprimtarisë së shoqatës dhe e përcjell zbatimin e programit;
- i miraton raportet tremujore dhe gjashtëmujore;
- udhëheq mirë dhe kujdeset për pasurinë dhe për mjetet e shoqatës;
- propozon revizor të pavarur (shoqëria për revizion);
- e miraton llogarinë përfundimtare;
- i përgatit dhe i zbaton vendimet e Kuvendit;
- vendos për shpërblimet dhe për mirënjohjet, dhe
- ushtron punë të tjera, në përputhje me këtë statut dhe me aktet e përgjithshme të shoqatës.

Neni 32

Këshilli ekzekutiv punon dhe vendos në seanca.

Këshilli ekzekutiv mban të paktën dy mbledhje në vit.

Mbledhjet e Këshillit ekzekutiv i thirr kryesuesi i Këshillit ekzekutiv, me nismën e vet, me kërkesën e tre anëtarëve të Këshillit ekzekutiv apo me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi i Këshillit ekzekutiv ka për detyrë të thirr mbledhje brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Thirrja e mbledhjes bëhet më ftesë në të cilën theksohet koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes si dhe propozimi i rendit të ditës.

Për punën e seancës (mbledhjes) mbahet procesverbal, të cilin e verifikon kryesuesi dhe një anëtar i Këshillit ekzekutiv.

Këshilli ekzekutiv nxjerr rregullore pune, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 33

Anëtarët e Këshillit ekzekutiv zgjidhen nga anëtarët e Kuvendit, nëpërmjet mekanizmit të votës së vetme të transferueshme (Single Transferable Vote - STV).

Anëtarët e Kuvendit mund të emërojnë çfarëdo numri anëtarësh, duke përfshirë edhe veten, të cilët do t'i radhitin sipas rangimit.

Vendet e zbrazëta të Këshillit ekzekutiv do të plotësohen sipas rangimit të siguruar me votimin STV.

Po qe se me votimin STV nuk plotësohet numri i duhur i vendeve, për vendet që kanë mbetur të paplotësuara do të zbatohet votim i ri STV, deri në plotësimin e plotë të tyre.

Neni 34

Anëtari i Këshillit ekzekutiv mund të shkarkohet nga pozita e tij, po qe se për një gjë të tillë votojnë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit ekzekutiv.

Neni 35

Punët profesionale dhe ato tekniko-administrative për nevojat e Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë i kryen kryetari i shoqatës.

Kryetari:

- përgatit raporte, analiza, informata dhe materiale të tjera për nevojat e organeve të shoqatës:

- i përgatit propozim-vendimet dhe aktet e tjera që i organet e shoqatës;
- kryen blerjen e materialit për konsumim për nevojat e shoqatës, dhe

- kryen punë të tjera, në përputhje me këtë statut dhe me aktet e përgjithshme të shoqatës.

VI. VEPRIMTARIA FINANCIARE DHE AFARISTE

Neni 36

Shoqata, mjetet për financim i krijon nga anëtarësimi, nga depozitat e themelimit, nga kontributet vullnetare, nga donacionet, nga dhuratat (në para, në të mira, të drejta pronësore), nga pasuritë e lëna me testament, nga legatat (gjëra të lëna me testament), nga veprimtaritë fitimprurëse, nga qiratë dhe qiramarrjet, si dhe nga të hyrat prej investimeve, dividendave, kamatave, huave si dhe nga të hyra të tjera, në përputhje me ligjin dhe me statutin.

Neni 37

Mjetet financiare të shoqatës përdoren për realizimin e objektivave të shoqatës, të përcaktuar me këtë statut dhe me programin e shoqatës si dhe në përputhje me rregullat dhe me kufizimet e burimeve të financimit.

Teprica e të hyrave të realizuara mbi shpenzimet (fitimi), duhet të përdoret për realizimin e objektivave të shoqatës, të përcaktuar me këtë statut dhe nuk mund të ndahet midis themeluesve, anëtarëve, anëtarëve të organeve, kryetarit, të punësuarve apo cilitdo person tjetër, të ndërlidhur me ta.

Neni 38

Viti financiar përputhet me vitin kalendarik.

Masa dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve të shoqatës Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë përcaktohet çdo vit me planin financiar, në bazë të planit vjetor afarist.

Planin vjetor afarist, duke përfshirë edhe planin financiar, e miraton Këshilli ekzekutiv.

Plani vjetor afarist miratohet në fund të vitit kalendarik në vazhdim, për vitin e ardhshëm.

Po qe se plani vjetor afarist nuk miratohet brenda afatit të parashikuar me paragrafin 4 të këtij neni, financimi do të kryhet në masën e mjeteve nga viti paraparak, të shtuara me ngritjen e çmimeve me pakicë në vitin në vazhdim.

Neni 39

Shoqata mban kontabilitet, mban dhe ruan regjistra, paraqet llogari vjetore dhe kryen regjistrim sipas mënyrës së parashikuar me ligj,

Këshilli ekzekutiv, veprimtarinë financiare e rregullon me akt të përgjithshëm.

Raportin e regjistrimit e miraton Këshilli ekzekutiv.

Neni 40

Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë ka raport vjetor, llogari vjetore dhe raporte financiare në përputhje me ligjin, me këtë statut dhe me aktet e përgjithshme të shoqatës.

Raporti vjetor përbëhet nga raporti për arritjet dhe nga raporti financiar. Përmbajtja e raportit vjetor dhe e raportit financiar është në përputhje me ligjin si dhe me standardet e raportimit financiar.

Përgjegjës për raportin vjetor, për llogarinë vjetore dhe për raportet financiare, përkatësisht për përgatitjen dhe për nënshkrimin e tyre është kryetari.

Po qe se buxheti vjetor i shoqatës është mbi 20.000 euro në kundërvlerën në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, Kuvendi mund të vendosë të kryhet revizioni vjetor i pavarur i veprimtarisë financiare, e po qe se buxheti është mbi 100.000 euro në kundërvlerën në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, të kryhet revizioni në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Raportin vjetor dhe raportin financiar për vitin paraprak, e miraton Kuvendi deri në 30 mars të vitit kalendarik më vazhdim, përkatësisht brenda afatit të caktuar me ligj.

Raporti vjetor dhe raporti financiar për vitin paraprak publikohen në ueb faqen e Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë, jo më vonë se deri më 30 prill të vitit kalendarik në vazhdim.

VII. MBROJTJA E INTERESAVE

Neni 41

Kryetari dhe anëtarët e organeve të shoqatës kanë për detyrë të administrojnë dhe të punojnë me vëmendje dhe në përputhje me parimet e administrimit të mirë, në interes të shoqatës dhe jashtë interesave personale, përkatësisht në interes të realizimit të objektivave, në përputhje me ligjin dhe me këtë statut.

Neni 42

Shoqata përgjigjet për detyrimet e veta me tërë pasurinë e vet dhe me të gjitha mjetet e veta.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit ekzekutiv përgjigjen personalisht dhe në mënyrë të pakufizuar për detyrimet e tyre ndaj shoqatës, për shpërdorimin e mjeteve të shoqatës, për të realizuar qëllime, të cilat për ta si individë, janë të ndaluara, apo për keqpërdorimin e shoqatës si person juridik, duke u shkaktuar dëm kreditorëve të vet.

Neni 43

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit ekzekutiv janë përgjegjës në mënyrë solidare për dëmin që i është shkaktuar shoqatës nga puna e tyre, po qe se dëmi është shkaktuar nga një pakujdesi e patolerueshme apo në mënyrë të qëllimshme, përveç kur me rastin e vendosjes nuk janë pajtuar me vendimin, gjë që e kanë shprehur në procesverbal apo në qoftë se nuk kanë marrë pjesë në marrjen e vendimit.

VIII. PUSHIMI I SHOQATËS

Neni 44

Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë pushon të ekzistojë po qe se:

- dy e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit merr vendim për pushimin e ekzistimit të shoqatës;
- numri i anëtarëve të shoqatës bie nën numrin e caktuar për themelim;
- afati i parashikuar i mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit është tejkaluar dyfish dhe mbledhja nuk është mbajtur;
- dy vite radhazi nuk është paraqitur llogari përfundimtare, në përputhje me ligjin;
- në rast ndryshimi të statutit me të cilin parashikohet pushimi i ekzistimit;
- është marrë vendim nga gjykata kompetente;
- në rast falimentimi ose
- në rast zbatimi të likuidimit.

Neni 45

Në rast pushimi të Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë, pasurinë dhe mjetet që mbeten pas shlyerjes së detyrimeve, do t'i ketë në dispozicion komuna e Tetovës. Komuna e Tetovës do t'i shfrytëzojë fondet e shoqatës për të blerë libra për nevojat e bibliotekës së qytetit të Tetovës.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 46

Interpretimin e dispozitave të këtij statuti e bën Kuvendi, ndërsa ndërmjet dy seancave të Kuvendit – Këshilli ekzekutiv.

Neni 47

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti kryhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë siç ka qenë mënyra dhe procedura e miratimit të tij.

Neni 48

Ky statut hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hapësirat e Asociacionit për edukim PENDA AEP Tetovë.

Vendi dhe data

Tetovë, më 24.03.2017

Asociacioni për edukim PENDA AEP Tetovë

Përfaqësues:

Mentar Mahmudi